

Regjistrimi në shkollën fillore për vitin 2027

Prashkollori i njohur edhe si (Përgatitor-(Prep)) është viti i parë i shkollës fillore në Victoria.

Fëmija juaj mund të fillojë shkollën nëse mbush 5 vjeç para datës 30 prill 2027. Shkollimi është i detyrueshëm pasi fëmija juaj të mbushë 6 vjeç.

Kur mund të aplikoj?

Aplikimet për t'u regjistruar në një shkollë fillore shtetërore në Viktoria për vitin 2027:

- Hapen nga **e hëna, 20 prill 2026**
- Deri **të premten, më 31 korrik 2026**.

Cilat janë të drejtat e regjistrimit të fëmijës tim?

Në Viktoria, fëmija juaj ka të drejtë të ndjekë shkollën e lagjes së caktuar ('shkollën tuaj vendore') sipas *Ligjit për Reformën e Arsimit dhe Trajnimit 2006*. Shkolla juaj vendore përcaktohet nga zona shkollore që lidhet me adresën tuaj të përhershme të banimit. Për të mësuar më shumë rreth mënyrës së marrjes së vendimeve për regjistrim, vizitoni faqen [Enrolling in School \(Regjistrimi në shkollë\)](#).

Si ta regjistroj fëmijën tim në vitin e parë të shkollës fillore?

Ja hapat për regjistrimin e fëmijës tuaj në vitin e parë të shkollës fillore:

1. Gjeni shkollën tuaj vendore

Vizitoni www.findmyschool.vic.gov.au për të gjetur shkollën fillore vendore ose shkollat më të afërta.

2. Kontaktoni shkollën

Kontaktoni shkollën fillore për të rezervuar një vizitë (opsionale). Konfirmoni nëse shkolla do të përdorë procesin e regjistrimit online (VicStudents) apo me letë formular. Ky informacion do të jetë i disponueshëm përmes faqes së internetit të shkollës.

3. Shkarkoni paketën informuese

Shkarkoni paketën informuese për regjistrimin në Parashkollor (Përgatitor-(Prep)) nga [Enrolling in Foundation \(Prep\)](#). Paketa do të jetë e disponueshme deri të enjten, 2 prill 2026.

4. Dorëzoni kërkesën tuaj për regjistrim

Dorëzoni një aplikim për regjistrim **deri të premten, më 31 korrik 2026**, qoftë në internet (VicStudents) ose duke përdorur letër formularin sipas procesit të përshkruar nga shkolla në faqen e tyre të internetit.

5. Merrni rezultatin

Do të njoftoheni për rezultatin e aplikimit tuaj për regjistrim **midis të hënës, 3 gusht dhe të premtes, 14 gusht 2026**. Nëse merrni një ofertë, duhet ta pranoni atë **deri të premten, më 28 gusht 2026**.

6. Përgatituni për kalimin e fëmijës suaj në shkollë

Merrni pjesë në seancat e tranzicionit të nxënësve gjatë termit të 4-të, 2026. Fëmija juaj do të fillojë programin Parashkollor nga **e enjtja, 28 janar 2027**.

Si mund ta gjej shkollën time vendore?

Gjeni shkollën tuaj vendore në faqen e internetit [Find My School](#) duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

1. Shkruani www.findmyschool.vic.gov.au në browserin tuaj të internetit.
2. Shkruani adresën tuaj të përhershme të banimit te "Enter your address to get started".
3. Zgjidhni vitin 2027 nën 'Enrolment year'. **Zonat shkollore për vitin 2027** do të jenë të disponueshme **deri të enjten, 2 prill 2026**.
4. Zgjidhni Primary (Fillore) te "School type".



Harta do të tregojë adresën tuaj, shkollën tuaj vendore dhe në të majtë, të dhënat e kontaktit të shkollës. Nëse lëvizni poshtë, do t'ju tregojë gjithashtu pesë shkollat më të afërta me adresën tuaj. Mund të kërkoni edhe sipas emrit të shkollës të "Search for school".

Çfarë ndodh nëse aplikimi im për regjistrim nuk është i suksesshëm?

Nëse aplikimi juaj nuk është i suksesshëm, ju mund të:

- **Aplikoni** në një shkollë tjetër. Fëmijës suaj i garantohet një vend në shkollën e tij/saj vendore. Vizitoni "[Find my school](#)" për të gjetur shkollën vendore të fëmijës suaj.
- Apelsoni vendimin. Faqja e [Enrolling in Prep \(Përgatitor-parashkollor\)](#) përmban informacion mbi procesin e apelimit të një rezultati të aplikimit për regjistrim.

Çfarë ndodh nëse humbas afatet e regjistrimit?

Ju mund të aplikoni për të regjistruar fëmijën tuaj në Parashkollor (Përgatitor) (Prep) për vitin shkollor 2027 në çdo kohë duke filluar nga **e hëna, 20 prill 2026**.

Edhe pse ju kërkohet të dorëzoni një aplikim për regjistrim **deri të premten, më 31 korrik 2026**, aplikimet e vonuara do të pranohen për familjet që mund të kenë humbur afatin e regjistrimit, të kenë ndërruar vendbanim të përhershëm ose të sapoardhur në Viktoria.

Aplikimet për regjistrim **të paraqitura pas datës 31 korrik 2026** do të menaxhohen nga shkolla fillore **sapo të pranohen**, në përputhje me Rregulloren e Regjistrimit të departamentit.

Ku mund të gjej më shumë informacion mbi regjistrimin në shkollën fillore?

Mund të kontaktoni shkollën tuaj fillore vendore për më shumë informacion mbi procesin e regjistrimit në Parashkollor (Përgatitor) (Prep).

Nga **e hëna, 20 prill 2026**, mund të gjeni gjithashtu një paketë informuese mbi procesin e regjistrimit në Parashkollor në faqen [Enrolling in Foundation \(Prep\)](#).

Nëse keni nevojë për ndihmë në përkthimin e paketës informuese, ju lutemi kontaktoni shkollën fillore vendore për ndihmë.

Kë duhet të kontaktoj për ndihmë?

Koordinatori i Tranzicionit, Nënpunësi i Regjistrimeve ose Drejtori i shkollës fillore ku dëshironi të aplikoni mund t'ju ndihmojnë me çdo pyetje që mund të keni në lidhje me procesin e regjistrimit.

Lidhje të dobishme

Ju lutemi gjeni disa lidhje më poshtë që mund të jenë të dobishme për ju ndërsa fëmija juaj fillon shkollën fillore:

Gjej Shkollën Time – findmyschool.vic.gov.au

Informacion mbi zonat shkollore – vic.gov.au/school-zones

Regjistrimi në Parashkollor (Përgatitor) (Prep) – vic.gov.au/enrolling-foundation-prep

Regjistrimi në shkollë – vic.gov.au/how-choose-school-and-enrol

Arsimi për aftësi të kufizuara dhe gjithëpërfshirës – vic.gov.au/disability-and-inclusive-education

Kontaktet e zyrës rajonale – vic.gov.au/office-locations-department-education

Afatet kohore për regjistrimet në Parashkollor (Përgatitor) (Prep) 2027

Datat e vitit 2026	Çfarë duhet të bëjnë prindërit/kujdestarët?
Termi 1	E martë, 27 janar (nxënësit fillojnë më 28 janar) – E enjte, 2 prill 2026
Termi 1 dhe 2, 2026	Merrni pjesë në vizitat shkollore të organizuara nga shkollat fillore (opsionale).
Deri të enjten, 2 prill 2026	Zonat shkollore për vitin shkollor 2027 janë të disponueshme. Mund ta gjeni shkollën tuaj vendore në www.findmyschool.vic.gov.au.
Termi 2	E hënë, 20 prill – E premte, 26 qershor 2026
Nga e hëna, 20 prill 2026	- Që nga fillimi i simestrit 2, plotësoni dhe dorëzoni aplikimin e fëmijës tuaj – qoftë në internet ose duke përdorur Formularin e Aplikimit në Pakon e Informacionit për Regjistrim, sipas udhëzimit të shkollës. - Mund ta shkarkoni Paketën e Informacionit për Regjistrimin nga Enrolling in Foundation për më shumë detaje.
Termi 3	E hënë, 13 korrik – E premte, 18 shtator 2026
Deri të premten, 31 korrik 2026	Dorëzoni aplikimin tuaj të plotësuar në shkollën fillore deri në këtë datë.
Midis të hënës, 3 gusht dhe të premtes, 14 gusht 2026	Shkollat fillore do t'ju njoftojnë me shkrim për rezultatet e aplikimit tuaj të regjistrimit gjatë kësaj periudhe. - Nëse aplikimi juaj nuk është i suksesshëm, mund të paraqisni një apelim në shkollën fillore.
Deri të premten, 28 gusht 2026	Konfirmoni pranimin e vendit të fëmijës suaj duke plotësuar Formularin e Regjistrimit të bashkangjitur me ofertën e regjistrimit. - Nëse keni ndërmend të apelonit, dorëzoni një apel me shkrim në shkollën tuaj fillore deri të premten, më 28 gusht.
Deri të premten, 11 shtator 2026	Shkollat fillore do t'ju njoftojnë me shkrim për rezultatet e apelimit.
Deri të premten, 18 shtator 2026	Nëse apelimi juaj në shkollën fillore nuk ka qenë i suksesshëm, mund të paraqisni një ankesë me shkrim te Drejtori Rajonal përkatës.
Termi 4	E hënë, 5 tetor – E premte, 18 dhjetor 2026
Termi 4, 2026	Merrni pjesë në seancat e tranzicionit të organizuara nga shkollat fillore.
Deri të premten, 6 nëntor 2026	Nëse keni paraqitur një apel te Drejtori Rajonal, rajoni do t'ju njoftojë me shkrim për rezultatin deri në këtë datë. Kjo vlen vetëm për apelet e pranuar deri në afatin përfundimtar të të premtes, 18 shtator.